

STATUTI
“ALMADINA TRADING” Shpk

I. THEMELIMI

NENI 1
Ortaku themelues

Shoqeria krijohet nga ne ortaket themelues sot me date 19.04.2024:

- **Z. Abdul Rauf Bhatti Bibi** shtetas spanjoll lindur me 03.11.1965 ne Gujrat, Pakistan me pasaporten me nr. PAL136816, madhor me zotesi te plote per te vepruar.
- **Z. Muhammad Akmal**, shtetas pakistanez lindur me 19.09.1979 ne Sargodha, Pakistan me pasaporten me nr. AE1352882, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

II. EMERTIMI, SELIA, FORMA JURIDIKE DHE OBEJKTI

NENI 2


Emertimi

Shoqeria emertohe “Almadina Trading”

NENI 3

Objekti

- 3.1 Aktivitet ne fushen e fastfood catering, restoranteve dhe delivery.
- 3.2 Aktivitete ne fushen e ndermjetesimit te punesimit te punonjesve shqiptare dhe te huaj ne shoqeri shqiptare dhe te huaja.
- 3.3 Import, eksporti dhe tregtim i produkteve ushqimore dhe pajisje mjekesore te te gjitha llojeve. Perkatesisht shoqeria do te kryeje dhe te gjitha veprimtarite e shitjes se drejtperdrejte te produkteve.
- 3.4 Aktivitete ne riparimin dhe lavazhin e makinave.
- 3.5 Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme brenda kufinjve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, si dhe mund te kryeje cdo operacion tregtimi ose financimi qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise.



3.6 Shoqeria me vendim te Administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo siper marrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj. Per me tej shoqeria do te ushtroje cdo veprimtari tregtare qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e mesiperem, duke perfshire, por pa u kufizuar vetem ne: a) pjesemarrjen ne cdo veprimtari me objekt te njejte ose te ngjashem, pavaresisht nga forma ligjore nen te cilen vepron; b) bashkepunimin me cdo person fizik ose juridik, dhe c) perfaqesimin e cdo shoqerie te huaj ose vendase qe ka objekt te njejte ose te ngjashem.

3.7 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme

NENI 4

Selia

4.1 Shoqeria "Almadina Trading" e ka seline e saj ne adresen Tirane Tirane Tirane, Rruga Pjeter Bogdani, Nd.10, H.5, Apt.28

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tille mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise dhe do te veproje nen mbikqyrjen e Administratoreve te "Almadina Trading" Shpk.

III. KOHEZGJATJA-KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

NENI 5

Kohezgjatja



Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

NENI 6

Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njqind) Leke dhe nuk eshte e paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:



- **Z. Abdul Rauf Bhatti Bibi** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete) Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Z. Muhammad Akmal**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50 (pesedhjete) Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 8


Tranferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjigjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributet ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



NENI 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme ne te cilen marrin pjese Ortaket e Shoqerise ose perfaqesuesit e tyre te pajisur me prokure te vecante dhe;
- b) Administratori/ret

NENI 10

Asambleja e Pergjithshme

8.1 Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblese se Pergjithshme.

8.2 Vendimet e Asamblese merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se "Almadina Trading" Shpk


8.3 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese se Ortakeve marrja e vendimeve persa i perket:

- Ndryshimin e Statutit
- Riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likudjimi, shnderrimi i shoqerise
- Zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre.
- Emerimi dhe shkarkimi i Administratorit
- Emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel
- Miratimi i bilancit
- Si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetet apo nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te sherbeje si perfaqesues i ortakeve pervec rastit kur autorizohet nga vete ortaku.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblene se pergjithshme, e cila perfshin dhe mbledhjet e tjera vijuese me te njejtin rend dite.



NENI 11

Menyra e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dites se parashikuar per mbledhjet e asamblese.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Mbledhja mund te zhvillohet ne seline fizikisht apo nepermjet komunikimit live me videokamere.

NENI 12

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me mjete elektronike.


Ne rast se Asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 me te njejtin rend dite.

NENI 13

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres per ceshtje te tjera si:



- Percaktimi i politikave tregtare te shoqersie
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportove te ecurise se veprimtarise
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Miratimin e rregullave procedural te mbledhjes se asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 14

Administratori

10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori ose administratoret, persona fizike qe mund te jene ose jo Ortak i Shoqerise.

10.2 Administratori eshte i detyruar te drejtoje shoqerine ne perputhje me Ligjin "Per shoqerite tregtare". Statutin, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe sipas dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

10.3 Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve, si dhe do te qendroje ne detyre per nje kohe prej 5 vjetesh.


10.4 Ne rast se ka me shume se nje Administrator, ata punojne bashkarisht ose vec e vec per te perfaqesuar shoqerine dhe interesat e shoqerise

10.5 Administratoret e pare te Shoqerise emerohen:


- **Z. Abdul Rauf Bhatti Bibi** shtetas spanjoll lindur me 03.11.1965 ne Gujrat, Pakistan me pasaporten me nr. PAL136816, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Nenshkrimi i Administratoreve:

Abdul Rauf Bhatti Bibi



10.5 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.



NENI 15

Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet

11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.

11.2 Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do jete e Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


11.3 Ky dokument redaktohet ne 4 (kater) kopje origjinale.

11.4 Per kryerjen e procedurave te regjistrimit prane QKB-se autorizohet administratori qe te perfaqesoje shoqerine per te gjitha veprimet e nevojshme prane ketij institucioni.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES

Abdul Rauf Bhatti Bibi



Muhammad Akmal

